

VENDIM
Nr. 443, datë 10.9.2021

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT “PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR NDRYSHIM”, QARKU LEZHË, ZNJ. ELDA ARTAN HOTI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1880/1 prot., datë 10.9.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes të z. Mark Pjetër Marku, i zgjedhur deputet në zonën zgjedhore qarku Lezhë, propozuar nga koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”.

Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 2.3.2021.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të zhvilluara më datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 414, datë 23.6.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese, në zonën zgjedhore qarku Lezhë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” për zonën zgjedhore qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.4.2021, ka fituar 4 (katër) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, qarku Lezhë, janë:

numri rendor 1 (një) z. Mark Pjetër Marku, numri rendor 2 (dy) z. Agron Nikolle Gjekmarkaj, numri rendor 3 (tre) znj. Lindita Ilir Metaliaj, numri rendor 4 (katër) z. Kastriot Pren Piroli,

rezulton se lista shumëmemërore e koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore qarku Lezhë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 163, pika 7 dhe nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 414, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me rendor 5, (pesë) znj. Elda Artan Hoti.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Për sa më sipër, kandidati për deputet, znj. Elda Artan Hoti, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 2513 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit. Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore qarku Lezhë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Elda Artan Hoti, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Mark Pjetër Marku, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Lezhë, i renditur me numër rendor 5, (pesë) znj. Elda Artan Hoti.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore qarku Lezhë, znj. Elda Artan Hoti (PR).
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi